



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:911207

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05752243

C.nr.3843/22

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil, gjyqtarja Edije Sezairi, në çështjen juridike të paditësve N.H. dhe D.H. të dy nga Prizreni të cilët me autorizim i përfaqëson e autorizuar avokate H.C. nga Prizreni, kundër të paditurit B.M. nga Prizreni, për shkak të kompensimit të dëmit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, me datë 05.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. PJESËRISHT APROVOHET kërkesëpadia e paditësve: N.H. dhe D.H. të dy nga Prizreni dhe **OBLIGOHET** i padituri B.M. nga Prizreni, që në emër të kompensimit të rentës të iu paguaj shumat si në vijim:

për paditësin N.H. për periudhën nga data 28.07.2002 e deri më 10.10.2008, në emër të mbajtjes së humbur - rentës të ia paguaj vlerën prej 4,930.78 euro, ndërsa për kamatë deri më datë 31.01.2017 të ia paguajë shumën prej 2,464.45 euro, e në shumë të përgjithshme në vlerë prej 7,395.23 euro;

për paditësen D.H. për periudhën nga data 28.07.2002 e deri më 10.10.2008, në emër të mbajtjes së humbur - rentës të ia paguaj vlerën prej 4,930.78 euro, ndërsa për kamatë deri më datë 31.01.2017 të ia paguajë shumën prej 2,464.45 euro, e në shumë të përgjithshme në vlerë prej 7,395.23 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

1. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësit N.H. dhe D.N. të dy nga Prizreni, përmes të autorizuarës së tyre avokate H.C. nga Prizreni kanë parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prizren, të cilën e kanë precizuar me parashtrësën e datës 20.04.2018, për shkak të kompensimit të dëmit në shumën e përgjithshme prej 56,844.47 eurove.

Gjykata Themelore në Prizren me aktgjykimin C.nr.779/15 të datës 24.04.2018 e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve, ashtu që e ka obliguar të paditurin B.M. që

paditësit N.H. në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material si dhe në emër të mbajtjes së humbur rentës, të ia paguaj shumën e përgjithshme prej 20,442.23 euro, ndërsa të paditurin e ka detyruar që paditëses D.H. në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material si dhe në emër të mbajtjes së humbur rentës, të ia paguaj shumën e përgjithshme prej 20,442.23 euro.

Gjykata e Apelit me aktgjykimin A.C.nr.4644/2019 të datës 20.07.2022 me aprovimin e pjesërishëm të ankesës së të paditurit, e ka ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.779/15 të datës 24.04.2018, ashtu që e ka gjykuar si vijon: Pjesërisht Aprovohet kërkesëpadia e paditësve N.H. dhe D.H. ty dy nga Komuna e Prizrenit si e bazuar, detyrohet i padituri B.M. nga Komuna Prizen, t'i paguaj paditësve, N.H. dhe D.H. nga Komuna e Prizenit, ne emer te demit jomaterial për shkak te vdekjes se babait te tyre, dhe atë ne rastin e ndodhur me datë 04.11.2002, në Rr. "....." Komuna Prizen, për dhimbjet e pësuar shpirtërore dhe atë: paditësit N.H. per dhimbjet e përjetuara shpirtërore për vdekjen e babait, shumën prej 8.000,00 Euro, (Tetëmijë euro), paditëses D.H. nga Komuna e Prizrenit për dhimbjet e përjetuara shpirtërore për vdekjen e babait, shumën prej 8.000,00 Euro (Tetëmijë euro), ndërsa pjesën tjetër përtej shumës së gjykuar për të dy paditësit, e ka refuzuar si të pa bazuar. Në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit e ka refuzuar të pathemelte ankesën e te paditurit, sa i përket vendosjes ne par. II (shpenzimet e varrimit, dhe shpenzimet e përmendores), te aktgjykimit te Gjykatës Themelore ne Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr. 779/15 date 24.04.2018, dhe i njëjti ne këtë pjese, është vërtetuar. Ndërsa e ka prishur aktgjykimin e Gjykatës Themelore ne Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr. 779/15 date 24.04.2018, sa i përket vendosjes në par. I, pika b) dhe atë lidhur me rentën mujore për te dy paditësit, dhe ne këtë pjese linda i është kthyer Gjykatës Themelore në Prizren për procedim te serishëm.

Duke vepruar sipas aktgjykimit A.C.nr.4644/2019 të datës 20.07.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Gjykata Themelore në Prizren ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin kryesor, në të cilin janë marrë parasysh vërejtjet e dhëna sipas aktvendimit të lartcekur.

Në shqyrtimin kryesor dhe në fjalën përfundimtare, e autorizuar e paditësve avokate Hana Canaj, ka mbetur pranë padisë, kërkesëpadisë dhe deklarimeve të bëra gjatë shqyrtimit kryesor, dhe propozojmë të aprovohet kërkesëpadia e paditësit në tërësi si e bazuar, po ashtu ka deklaruar se eksperti financiar në mënyrë të detajuar i ka dhënë shpjegimet dhe ka sqaruar lidhur me mbajtjen e humbur të paditësve N. dhe D.H. duke theksuar se secilit prej tyre ju takon e drejta në mbajtjen e humbur për periudhën prej ditës së incidentit me datë 28.07.2022 e deri më datë 10.10.2008 kur ata e kanë arritur moshën madhore, mbajtja e humbur për secilin prej tyre e arrin vlerën prej nga 4,930.78 euro. Kamata e llogaritur në këtë shumë me normë si për mjetet të afatizuara mbi 12 muaj pa destinim të caktuar sipas arritjeve mujore për pagesë deri më datë 31.01.2017 e arrin vlerën prej 2,464.45 euro. Pra për secilin prej paditësve të lartcekur mbajtja e humbur së bashku me kamatë të llogaritur deri me 31.01.2017 e arrin vlerën prej 7,395.23, që i bie se për të dy paditësit renta e llogaritur deri më datë 10.10.2008 kur të dy paditësit e kanë arritur moshën e pjekurisë së bashku me kamatë të llogaritur deri në ditën e kryerjes së ekspertizës me datë 31.01.2017 e arrin gjithsej shumën prej 17,790.72 euro, duke shtuar se pas administrimit të provave në tërësi është vërtetuar kërkesëpadia e parashtruar në lidhje me kompensimin e mbajtjes së humbur – rentës. E autorizuar e paditësve gjithashtu i ka propozuar gjykatës që të aprovoj shumën e mjeteve në emër të kompensimit për mbajtjen e humbur rentës për paditësit N. dhe D.H. të cilën eksperti gjyqësor financiar e ka dhënë në shqyrtim me datë 05.02.2024. Shpenzimet procedurale nuk i ka kërkuar.

Në seancat e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, i padituri ka deklaruar se mbetet në tërësi nga të dhënat e cekura në përgjigjen në padi dhe se e konteston në tërësi padinë e ngritur ndaj tij me arsye se padia është bazuar në aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Ap.nr.202/2005 të datës 13.10.2005, është shpallur fajtor në mënyrë arbitrare, pa prova për këtë vepër penale. Gjithashtu i padituri në fjalën përfundimtare ka kundërshtuar provat dhe besueshmërinë e tyre të cilat janë paraqitur andaj ka kërkuar nga gjykata që të njëjtat të konsiderohen si të pavlefshme dhe se padia është e pabazuar.

2. Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: ka bërë leximin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ap.nr.202/2005, të dt. 13.10.2005, ka lexuar Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren P.nr.161/2004, të dt.22.02.2005, ka lexuar Dëshminë mbi vdekjen e D.H. e lëshuar nga Komuna e Prishtinës, ka lexuar Çertifikatën e vdekjes në emër të D.H.M. lëshuar nga Shërbimi Ofiqarisë-Komuna së Prishtina me dt.16.07.2009, ka lexuar çertifikatën me numër 08/351 me dt.19.02.2013 të lëshuar nga Zyra Komunale për Punësim në Prizren, për papunësinë paditëses D.H. gjithashtu ka lexuar çertifikata me numër 08/348 me dt.15.02.2013 të lëshuar nga Zyra Komunale për Punësim në Prizren, për papunësinë paditësit N.H. e ka lexuar çertifikatën që nuk posedon pasuri të paluajtshme paditësi N.Q.H. lëshuar 19.02.2013 nga Komuna e Prizrenit, e ka lexuar çertifikatën që nuk posedon pasuri të paluajtshme paditësi D. H. të lëshuar me datë19.02.2013, ka lexuar çertifikatën e lindjes së D.H. lëshuar nga Shërbimi i Ofiqarisë-Komuna e Prizrenit me numër rendor 4409/1990, numri i certifikatës 71291, me dt. 29.12.2008, po ashtu ka lexuar certifikatën e lindjes së N.H. lëshuar nga Shërbimi i Ofiqarisë-Komuna e Prizrenit me numër rendor 2912/1985, numri i certifikatës 71293, me dt. 29.12.2008, ka lexuar certifikatën me numër ZP-Prizren 94784-11353-2016-1856, me dt.13.12.2016 të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Zyra në Prizren, për papunësinë paditësit N.H. po ashtu ka bërë leximin e Ekspertizës nga lëmit e sigurimeve, aktuaristikës dhe financiare e dt. 31.01.2017, përpiluar nga eksperti gjyqësor, Prof. A.B. nga Prishtina si dhe është bërë dëgjimi i ekspertit në shqyrtimin e datës 05.02.2024.

3. Faktet

Gjykata pas vlerësimit të provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është **e bazuar** dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase ka konstatuar gjendjen faktike si më poshtë.

Me leximin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ap.nr.202/2005, të dt. 13.10.2005, është vërtetuar fakti se me anë të këtij aktgjykimi është ndryshuar aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, lidhur me cilësimin juridik dhe vendimit për dënim, ku i padituri B.M. është dënuar me dënim me burgim afatgjatë në kohëzgjatje prej 24 vjetësh.

Me leximin e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prizrenit, P.nr.161/2004, të datës 22.02.2005, gjykata ka vërtetuar faktin se i padituri B.M. është shpallur fajtor për shkak të veprës penale si bashkezekutor i vrasjes së rëndë nga neni 147 parag.4 të KPK-së, pasi që me pushkë automatike disa herë në anëtarët e familjes H. ku nga veprimi i predhës i po ashtu është goditur edhe i ndjeri Q.H. dhe ka pësuar lëndime të rënda në regjionin e barkut, nga të cilat plagë ka vdekur me 4 nëntor të vitit 2002 në Spitalin e Prishtinës.

Me leximin e lejes së vendqëndrimit në Itali për të ndjerin Q.H. gjykata ka konstatuar se i ndjeri Q.H. lejen e vendqëndrimit në shtetin e Italisë, për herë të parë është pajisur me dt. 06.07.1999 dhe të njëjtën e ka vazhduar me dt. 27.09.2000 dhe që e njëjta ka pas afat skadence deri me dt. 30.06.2001.

Me leximin e dëshmisë mbi vdekjen e D.H.M. të lëshuar nga Komuna e Prishtinës me dt. 11.12.2009, është vërtetuar fakti se D.H. e lindur M. u lind me dt. 10.08.1958, në f.sh Rakovicë-Beograd, Republika e Serbisë. Gjithashtu konstatohet se e lartcekura me dt. 11.05.2008, ka ndërruar jetë në Prishtinë, ku nga kjo dëshmi është vërtetuar se e njëjta ka pas dy fëmijë N.H.dhe D.H.

Nga leximi i certifikatës mbi papunësinë të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Qendra Regjionale për Punësim-Zyra Komunale për Punë dhe Punësim në Prizren me nr. 08/351, dt.19.03.2013, në emër të paditëses D.H. është vërtetuar fakti se lartpërmendura është regjistruar me statusin si e papunë dhe atë prej dt. 19.02.2013.

Nga leximi i certifikatës mbi papunësinë të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Qendra Regjionale për Punësim-Zyra Komunale për Punë dhe Punësim në Prizren me nr. 08/348, dt.19.03.2013, në emër të paditësit N.H. është vërtetuar fakti se i lartpërmenduri është regjistruar me statusin si e papunë dhe atë prej dt. 15.02.2013.

Me leximin e certifikatës të lëshuar nga Minsitria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - Agjencia Kadastrale e Kosovës, me numër të protokollit: 023-628/n.s, të dt. 19.02.2013, është vërtetuar fakti se paditësi N.Q.H. nuk posedon asnjë pronë të regjistruar në regjistrin e paluajtshmërisë.

Me leximin e certifikatës së lindjes së D.H. të lëshuar nga Komuna e Prizrenit me dt. 29.12.2008, me numër të certifikatës 71292 e numër rendor 4409/1990, gjykata ka vërtetuar se Dafina Haziraj është lindur me dt. 10.10.1990, në Prizren, nga prindërit Q.H. dhe D.M.

Me leximin e certifikatës së lindjes së N.H. të lëshuar nga Komuna e Prizrenit me dt. 29.12.2008, me numër të certifikatës 71293, e numër rendor 2912/1985, gjykata ka vërtetuar se N.H. është lindur me dt. 05.08.1985, në Prizren, nga prindërit Q.H. dhe D.M.

Nga leximi i deklaratës së papunësisë të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, me dt. 13.12.2018, është vërtetuar fakti se N.H. ka statusin e të papunësuarit, me profesion punëtor për vendosjen e betonit, përfundimin e betonit dhe të natyrës së ngjashme, ka ndjekur këshillime profesionale që ofron Zyra për punësim në Prizren, dhe i gatshëm për punë krahu në ndërtimtari.

Me leximin e ekspertizës nga lëmitë e sigurimeve, aktuaristikës dhe financave të ekspertit Prof. A.B. nga Prishtina, në lidhje me llogaritjen e mbajtjes së humbur për familjen e të ndjerit Q.H. gjykata ka konstatuar se si pasojë e vdekjes së të ndjerit Q.H. familjes së të ndjerit gëgjësisht fëmijëve N. e D.H. u takon kompensimi i dëmit material në formë të mbajtjes së humbur- rentës, e cila arrin vlerën prej 9,861.86 Euro, që së bashku me kamatë të llogaritur deri më 31.01.2017, si për mjetet e afatizuara mbi 12 muaj pa destinim të caktuar prej 4,928.91 Euro, që arrin shumën totale prej 14.844,47 euro, ndaras për secilin paditës nga 7.442,23 euro. Edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor eksperti Prof. A.B. nga Prishtina, ka sqaruar mënyrën e përlllogaritjes së rentës dhe metodave që ka përdorur gjatë përlllogaritjes së kësaj rente, respektivisht në shqyrtimin e datës 05.02.2024 ka deklaruar se lidhur me mbajtjen e

humbur për periudhën prej ditës së incidentit me datë 28.07.2002 e deri më 10.10.2008 kur ata e kanë arritur moshën madhore, mbajtja e humbur për secilin prej tyre e arrin vlerën prej nga 4,930.78 euro, ndërsa kamata e llogaritur në këtë shumë me normë si për mjetet e afatizuara mbi 12 muaj pa destinim të caktuar e sipas arritjeve mujore për pagesë deri më datë 31.01.2017 e arrin vlerën prej 2,464.45 euro. Pra për secilin paditës mbajtja e humbur së bashku me kamatë të llogaritur deri më 31.01.2017 e arrin vlerën prej 7,395.23 euro, e që për të dy paditësit renta e llogaritur deri me 10.10.2008 kur të dy e kanë arritur moshën e pjekurisë, së bashku me kamatë e cila është llogaritur deri në ditën e kryerjes së ekspertizës me datë 31.01.2017 e arrin gjithsej shumën prej 14,790.72 euro.

4. Baza Ligjore

Në këtë çështje juridike kontestimore do të zbatohet dispozitat ligjore të parapara me me Ligjin e Marrëdhënieve të Detyrimit të vitit 1978, i zbatueshëm sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/24, për shkak se marrëdhënia detyrimore kontestuese është krijuar në kohën kur ka qenë në fuqi ky ligj. Bazuar nenin 194 parag.1, i cili parasheh se: “Personi të cilin i vrari e ka ushqyer ose e ka ndihmuar rregullisht, si dhe ai që sipas ligjit ka pasur të drejtë të kërkojë ushqim nga i vrari, ka të drejtë kompensimi të dëmit që pëson humbje e ushqimit ose të ndihmës”, ndërsa në paragrafin 2 të nenit të lartcekur parashihet “ky dëm kompensohet me pagimin e rentës në të holla, shuma e së cilës caktohet duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit, e që nuk mund të jetë më madhe nga ajo që do të fitonte i dëmtuari nga i vrari po të mbetej gjallë”. Neni 200 parasheh kompensimin në të holla, më saktësisht në paragrafin 1 përcaktohet se “Për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të jetesës, të prishjes, të shkeljes së nderit ose lirisë, të vdekjes së personit të afërm , si dhe për frikën, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit, sidomos intensiteti i dhimbjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e justifikon këtë, do të gjykojë kompensimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga kompensimi i dëmit material, si dhe nga mungesa e dëmit material”. Paragrafi 2 i nenit 200 parasheh “Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërben ky kompensim e gjithashtu edhe për faktin se mos të u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”.

Neni 201 paragrafi 1 i LMD-së parasheh „Në rast vdekjeje të ndonjë personi, gjykata mund t'u gjykojë anëtarëve të familjes së tij të ngushte (bashkëshorti, fëmijët dhe prindërit) kompensim të drejtë në të holla për dhimbjet e tyre shpirtërore“

5. Vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës

Pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha pretendimet e palëve ndërgjyqëse dhe provave të administruara në këtë çështje kontestimore, gjykata konstatoi se kërkesëpadia e paditësve sa i përket rentës është e bazuar.

Nga provat e administruara gjatë procesit gjyqësor dhe faktet e vërtetuara, del se nuk është kontestuese fakti se i padituri B.M. është shpallur fajtor për shkak të vdekjes së të ndjerit Q.H. pasi që i ndjeri nuk ka arritur të i mbijetoj plagëve të marra nga plagosja me armë zjarri dhe vdes me 04.11.2002 në Spitalin e Prishtinës.

Po ashtu nga provat e administruara gjykata ka vërtetuar faktin se i ndjeri Q.H., ka qenë i martuar me D.H.M. dhe nga kjo martesë kanë pasur dy fëmijë N.H.- djali i tyre dhe D.H.- vajza e tyre këtu paditësit, të cilët kanë jetuar në bashkësi familjare me të ndjerin Q.H. i

cili ka qenë mbajtës kryesor i familjes së tij, fakt i cili është vërtetuar nga certifikatat e fëmijëve, e po ashtu duke pasur parasysh se gruaja e tij D. ka qenë amvise dhe fëmijët kanë qenë të vegjël, ka qenë i vetmi i punësuar në familje. Nga dëshmia e vdekjes është vërtetuar se bashkëshortja e të ndjerit Q.H., D.H.M. ka ndërruar jetë me 11.05.2008 në Prishtinë.

Duke pasur parasysh se anëtarët e familjes së ngushtë të Q.H. kanë humbur personin i cili i ka mbajtur (ushqyer) gjykata në bazë të raportit të përpiluar nga eksperti i aktuaristikës dhe financave në emër të mbajtjes së humbur rentës Prof. A.B. ka caktuar që renta të paguhet në formë të kapitalizuar në shumën e përgjithshme prej 14.844,47 euro, në mënyrë të precizuar për të dy paditësit N. e D.H. shumën nga 7.442,13 euro për secilin, respektivisht paditësve iu takon kompensimi në rentë për periudhën prej ditës së incidentit me datë 28.07.2002 e deri më 10.10.2008 kur ata e kanë arritur moshën madhore, mbajtja e humbur për secilin prej tyre e arrin vlerën prej nga 4,930.78 euro, ndërsa kamata e llogaritur në këtë shumë me normë si për mjetet e afatizuar mbi 12 muaj pa destinim të caktuar e sipas arritjeve mujore për pagesë deri më datë 31.01.2017 e arrin vlerën prej 2,464.45 euro. Pra për secilin paditës mbajtja e humbur së bashku me kamatë të llogaritur deri më 31.01.2017 e arrin vlerën prej 7,395.23 euro, e që për të dy paditësit renta e llogaritur deri me 10.10.2008 kur të dy e kanë arritur moshën e pjekurisë, së bashku me kamatë e cila është llogaritur deri në ditën e kryerjes së ekspertizës me datë 31.01.2017 e arrin gjithsej shumën prej 14,790.72 euro dhe atë duke u bazuar në nenin 194 parag.1, i cili parasheh *“Personi të cilin i vrari e ka ushqyer ose e ka ndihmuar rregullisht, si dhe ai që sipas ligjit ka pasur të drejtë të kërkojë ushqim nga i vrari, ka të drejtë kompensimi të dëmit që pëson humbje e ushqimit ose të ndihmës”,* ndërsa në lidhje me lartësinë e shumës për pagesën në formë të rentës gjykata e aprovoj dhe atë duke u bazuar në paragrafin 2 të nenit 194, ku parashihet *“ky dëm kompensohet me pagimin e rentës në të holla, shuma e së cilës caktohet duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit, e që nuk mund të jetë më madhe nga ajo që do të fitonte i dëmtuari nga i vrari po të mbetej gjallë”*.

Nga të cekurat më lartë dhe bazuar në nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i përgjithshëm
C.nr.3843/22 datë 05.02.2024

Gjyqtarja
Edije Sezairi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.